

VENDIM
Nr.601, datë 23.7.2010

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, MINISTRISË SË PUNËVE
PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË
OBJEKTIT “ISH-KOPSHTI NR.26”, NË TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale, për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, të pronës së paluajtshme shtetërore, objektit “ish-kopshti nr.26”, në rrugën “Kostaq Cipo”, Tiranë, me numër pasurie 5/131, numër kadastral 8180, P-7, me numër rendor 346, në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave të lidhë kontratat e privatizimit me banorët, të përfshirë në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas kushteve të privatizimit, të përcaktuara me udhëzim të veçantë të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Enti Kombëtar i Banesave të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

Nr.	Emër, mbiemër
1	Dylber Sadik Vasha
2	Tomor Sadik Vasha
3	Artur Estref Myrteza
4	Fatbardha Izet Myrteza
5	Elida Hysen Burimi
6	Ramadan Hysen Metko
7	Pembe Ali Ceku
8	Bardhyl Bektash Vasha
9	Napolon Ferid Myrteza
10	Ferit Avdyl Myrteza